



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:239062

Datë: 08.08.2024

Numri i dokumentit: 06032867

Në çështjen juridike të :

AC-I-23-0084

Paditësi

A I, nga fshati S, Komuna e Vitisë të cilin e përfaqëson avokati H L nga Vitia.

Kundër:

E paditura/Ankuese

N.SH. N.B.I "Agromorava" (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, gjyqtarë duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-6942, të datës 25 janar 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur 08 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet, Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-6942, i datës 25 janar 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 01 nëntor 2014, paditësi kishte parashtruar një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI035-0239 të datës 01 tetor 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 600.00 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme, me arsyetimin se kërkesa është e parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Paditësi ka theksuar se ka punuar në NSH,, Agromorava” deri në momentin kur ka filluar proceduar e likuidimit më datë 25 nëntor 2005.

Paditësi ka shtuar se padrejtësisht me Vendimin e autoritetit të likuidimit më është refuzuar kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën 600.00 euro për tri paga. Ka kërkuar që të miratohet ankesa/kërkesa e tij dhe të obligohet e paditura t’ia kompensoi tri paga bruto në shumën prej 600.00 euro. Ankesë ja ka bashkangjitur: Kopjen e Librezës së punës, Njoftimin për ndërprerje të kontratës së punës datë 25 nëntor 2005.

Më 26 korrik 2022, AKP-ja përmes përfaqësuesit ka dorëzuar parashtresën në mbrojtje ndaj ankesës se paraqitur kundër Vendimit GJI035-0239 të AL me propozimi që ankesa të refuzohet. Ka theksuar se kërkesa e paditësit është parashkruara konform nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, duke konsideruar si të drejtë dhe të saktë vendimin e AL. Po ashtu ka theksuar se NSH NBI,, Agromorava” ka hyrë në procedurë të likuidimit më datë 25 tetor 2005 ndërsa më datë 26 gusht 2014, parashtruesi regjistroi një kërkesë për dëmshpërblim për ndërprerje të kontratës së punës në shumë 600.00 euro. Vendimi i AL është mbështetur në afatet dhe bazat ligjore në vijim: neni 36.2.2 i Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP-në, parashikon,, elementet në vijim përbejnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë. Kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme. Neni 608 i Ligjit për punën e bashkuar parashikon që pagesa e shumës së pagës apo rrogës apo secilës kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vite. Në bazë të dispozitave të mësipërme kërkesa duhet të ishte paraqitur në gjykatë apo të ndo një autoritet tjetër brenda afatit prej tri vite nga momenti kur NSH të

mos ketë përmbushur obligimin e tij më të hershem ose deri në qershor të vitit 2008.

Më 11 janar 2023, i autorizuari i paditësit ka dorëzuar parashtresën me të cilën është deklaruar se paditësit ju është ndërprerë kontrata e punës më datë 25 nëntor 2005 kur ju ka dorëzuar njoftimin AKM-ja për shkak të privatizimit dhe se paditësi nuk ka dokumentacion sepse objekt i të paditurës është djegur. Paditësi ka aplikuar për kërkesën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 600.00 euro, ose për tre paga nga 200.00 euro. Paditësi i ka bashkangjitur këto prova: kopjen e dokumentit identifikues, vendimin e AL GJI035-0239, Regjistrin e 20%, Njoftimi i datës 25 nëntor 2005, konfirmimi i policisë për zjarrevenjë të datës 19 prill 2011 si dhe autorizimin e avokatit për përfaqësim.

Me 25 janar 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-6942 kishte aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit, duke ndryshuar kështu vendimin e AL-së me nr. GJI035-0239 të datës 01 tetor 2014 dhe ka obliguar të paditësin NSH NBI „Agromorava“ që paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, t’ia paguajë për 3 (tre) paga në shumën 600.00 euro , sipas nenit 40 paragrafi 1.pika 1.6.2 e shtojcës së ligjit nr.04/L-034.

Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet provat të cilat i ka ofruar paditësi dhe pretendimet në kërkesë si dhe pretendimet e të paditurës në parashtresë të mbrojtjes dhe provat e dorëzuara ka konstatuar se nuk është kontestuese fakti se paditësi ishte punëtor i të paditurës. Në parashtresë të mbrojtjes dhe provat e dorëzuara ka konstatuar se nuk është kontestuese fakti se paditësi ishte punëtor i të paditurës deri në ditën kur të njëjtit ju është dorëzuar njoftimi për përfundimin e kontratës së punës më datë 25 nëntor 2005 , për shkak të shitjes së aseteve të NSH-së. Si kontestuese është parashkrimi i kërkesës. Me njoftimin, e datës 25 nëntor 2005 të lëshuara nga AKM-ja paditësi është informuar në lidhje me përfundimin e marrëdhënies së punës, ndërsa sipas njoftimit ,, shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto proceduara”.

Shkalla e I-rë ka konstatuar se me Kopjen e Librezës së Punës i njëjti ishte i punësuar të e paditura dhe kishte përvojë pune 13 vite e 7 muaj e 10 ditë. Me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit GJI035-239 datë 01 tetor 2014 për NSH NBI“ Agromorava” kërkesa e ushtruar nga paditësi për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 600.00 euro, është refuzuar duke u mbështetur në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 dhe nenin 608, të Ligjit për punën e Bashkuar. Tutje , shkalla e I-rë ka konstatuar se dokumenti i njoftimit i datës 25 nëntor 2005 i lëshuar nga AKM-ja me të cilin paditësit i ka përfunduar punësimi si pasojë e shitjes së aseteve të NSH, ka prodhuar efekt juridik si për paditësin si punëtor ashtu edhe për NSH,, Agromorava”, si punëdhënës sa i përket pushimit të marrëdhënies së punës. Me të njëjtin dokument e ka pranuar faktin se shumatat-pagat, të cilat nuk ju janë paguar punëmarrësit mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe kërkesa e tillë do të shqyrtohet në procedurën e likuidimit duke marruar për obligim që paditësi të kontaktohet kur të fillon kjo procedurë. Me dispozitën e nenit 40 paragrafi 1.pika 1.6.2, e shtojcës së Ligjit nr.04/L-034, është paraparë,, kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e vendimit për Likuidim të Ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin nga agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në. Shkalla e parë, ka konstatuar se pas ne baze te kësaj gjendje faktike e cila ndryshon nga konstatimi i gjendjes faktike nga Autoriteti i Likuidimit, Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar në mënyrë të gabuar faktin se është parashkruar kërkesa dhe si rrjedhojë e kësaj ka zbatuar në mënyrë të gabuar edhe dispozitën e nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L034. Bazuar në faktin se paditësi kishte stazh pune 13 vite, ndërsa sipas nenit 12, paragrafi 2, pika (dh) nën (III), të Ligjit Themelor të Punës i vitit 2001, ku është paraparë për 10 vite deri në 19 vite stazh pune, punëtorit i takojnë 3 (tre) paga mujore. Ashtu që në rastin konkret duke marrë për baze pagën mujore, për tre paga mujore 200.00 euro, për tre paga është gjykuar shuma 600.00 euro. Andaj me rastin e pranimit të kërkesës së paditësit për paga të pa paguara, ka zbatuar dispozitën e nenit 40 paragrafi 1, pika 1.6.2 të Shtojcës së ligjit , nr.04/L-034.

Me 13 shkurt 2023, e paditura (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-6942 të datës 25 janar 2023, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, ashtu që të refuzohet ankesa ndaj vendimit të AL-së si e pabazuar duke vërtetuar vendimin e Autoritetit

të Likuidimit. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë dy afatet e parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit është i obliguar t'i pranoj dhe përmes të cilave aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëj me afatin për parashtrim të kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit, ndërsa afati i dytë ka të bëj me natyrën (meritat) e së drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë. Këto dy afate duhet të përmbushen nga një kreditor në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet e nëse një kreditor dështon të përmbushë një prej këtyre afateve, kërkesa e tij do të refuzohet pavarësisht faktit se ai ka përmbushur afatin tjetër. Tutje, pala kundërshtarë sqaron gjykatën se njoftimi që i referohet parashtruesi e informon atë se ai ka të drejtë të parashtrtoj kërkesën pranë AKP-së dhe se kërkesa të tilla do të shqyrtohen në likuidim. Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj Ex officio. Ankesës i kishte bashkëngjitur Aktgjykimin e ankimuar dhe vendimin e ankimuar të AL-së.

Me 24 shkurt 2024, paditësi e kishte pranuar ankesën e të paditurës (AKP), mirëpo nuk kishte parashtruar përgjigje.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa të paditurës refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar shkallës së parë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 600.00 euro, ishte refuzuar si

e pavlefshme nga AL me vendimin GJI035-0239, me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij të paraqitur kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit, kishte bashkëngjitur këto prova: Njoftimin për ndërprerjen e punës e datës 25 nëntor 2005, kopjen e librezës së punës së paditësit.

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditësit të drejtën në dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në shumën prej 600.00 euro, pasi që i njëjti kishte dorëzuar provë relevante si letërpezullimin e datës 25 nëntor 2005 me të cilin paditësi ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon menjëherë si dhe kopjen e librezës së punës së paditësit.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS kishte vepruar drejtë me rastin e njohjes se kërkesës së paditësit për kompensimin për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kjo për faktin se nga Njoftimi i AKP për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit, i cili është i bashkëngjitur si provë në shkresa të lëndës, shihet që paditësit i është ndërprerë parashkrimi i kërkesës për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, kur kishte filluar privatizimi i ndërmarrjes në fjalë, pra me 25 nëntor 2005. Ky njoftim në përmbajtjen e tij theksonte se *"shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me Punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e Punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura"*.

Prandaj, paditësi duke vepruar konform njoftimit që i është bërë me datë 25 nëntor 2005, ashtu siç theksohet edhe në vendimin e Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit për dorëzimin e kërkesave, me datë 26 gusht 2014 kishte paraqitur kërkesën për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument

ligjor apo provë me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë ka vepruar drejtë kur paditësit i ka njohur të drejtën në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 600.00 euro.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së 08 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues _____